

**NJOFTIM**  
**PËR MBLEDHJEN E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME**  
**TË AKSIONERËVE TË "BANKA CREDINS" SH.A.**

Për: Z/Znj. \_\_\_\_\_ (Aksioner/Perfaqesues/e i/e Aksionerit \_\_\_\_\_)

Ju njoftojmë se ditën e Enjte datë 28 Janar 2016, ora 14:00 në ambientet e "BANKA CREDINS" SH.A., në adresën Rr. "Ismail Qemali" Nr. 4, Tiranë, do të zhvillohet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të "BANKA CREDINS" SH.A me rend dite si më poshtë:

1. Propozim për miratimin e ndryshimit ne nenin 19.1 te Statutit te Bankes Credins sh.a si me poshte:

Ishte: 19.1 Mbledhjet e Këshillit Drejtues do të mbahen **të paktën 6 herë në vit**, dhe do të konsiderohen të mbledhura rregullisht vetëm nese mungon jo me teper se nje anetar. Nëse një mbledhje, nuk është e mbledhur rregullisht për shkak të mungesës se kuorumit, kjo mbledhje do të shtyhet për një datë tjetër jo më pak se 2 ditë pune nga mbledhja e parë dhe ne kete rast mbledhja do te zhvillohet me pranine e me shume se gjysmës se anëtarëve te Keshillit Drejtues.

Behet: 19.1 Mbledhjet e Këshillit Drejtues do të mbahen **të paktën 4 herë në vit**, dhe do të konsiderohen të mbledhura rregullisht vetëm nëse mungon jo me teper se nje anetar. Nëse një mbledhje, nuk është e mbledhur rregullisht për shkak të mungesës se kuorumit, kjo mbledhje do të shtyhet për një datë tjetër jo më pak se 2 ditë pune nga mbledhja e parë dhe ne kete rast mbledhja do te zhvillohet me pranine e me shume se gjysmës se anëtareve te Këshillit Drejtues.

2. Propozim per dhënien e miratimit lidhur me përfaqësimin e Bankës Credins nga z.Maltin Korkuti ne mbledhjen e Asamblesë se Përgjithshme te Jashtëzakonshme te Aksionareve te Shoqërisë Administruese te Fondit te Pensionit SiCRED sh.a me date 05.02.2016 me rend dite si me poshtë:

1. Mbi miratimin e strukturës aksionare të Shoqërisë Administruese të Fondit të Pensionit SiCRED sh.a..
2. Çështje të tjera parashikuara shprehimisht nga ligji.

Jeni të lutur të paraqiteni. Ju Faleminderit.

**Maltin KORKUTI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**



Tirane me 07.01.2016

